



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 117 AKTI

NR. 103 VENDIMI
Tiranë, më 5.2.2019

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 2 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Olsi Komici	Anëtar
Valbona Sanxhaktari	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, më datë 22.1.2019, ora 10:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Donika Prela**, prokurore/ drejtuese në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e pranishme në seancën dëgjimore.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

RRETHANAT E ÇËSHTJES:

1. Znj. Donika Prela është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të saj si prokurore/drejtuese në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Bazuar në nenin 4, pika 4, dhe në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e në vijim referuar si “Komisioni”) ka hedhur shortin më datë 15.3.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2.
2. Menjëherë, pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe grupi i punës së Prokurorisë së Përgjithshme. Subjekti u kontaktua nëpërmjet adresës elektronike të deklaruar prej saj për hetim të mëtejshëm, ku iu dërgua edhe pyetësori i përgatitur nga Komisioni.
3. Me vendimin e trupit gjykues datë 21.3.2018 është vendosur kryesues z. Roland Ilia, si dhe është deklaruar mospasja e konfliktit të interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues që do të kryente procesin e rivlerësimit, ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me asnjë nga pjesëtarët e tij.
4. Më datë 20.12.2018, trupi gjykues, bazuar në relatin mbi rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes, vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Donika Prela, bazuar në të tre kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, ta ftojë atë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.
5. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj. Ajo paraqiti shpjegime dhe prova lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit të Komisionit.
6. Trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Donika Prela, në seancë dëgjimore, në datën 22.1.2019, ora 10:00 paradite, në Pallatin e Koncerteve, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

SEANCA DËGJIMORE

7. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 22.1.2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.
8. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë dhe paraqiti shpjegime lidhur me hetimin e bërë kryesisht nga Komisioni. Znj. Donika Prela paraqiti provat ku mbështeteshin shpjegimet e saj, ajo dha shpjegime lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit, dhe iu përgjigj pyetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin e saj në detyrë.
9. Më datë 28.1.2019, trupi gjykues mori një denoncim publik të shpërndarë nëpërmjet mediave, për të cilën vlerësoi si të nevojshëm verifikimin e tij. Për këto shkaqe, trupi gjykues njoftoi shtyrjen e seancës së datës 29.1.2019 në datën 5.2.2019.
10. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit kryen verifikimet përkatëse, të cilat çuan në përfundimin se deri në atë moment nuk ekzistonte asnjë indicie që mund të çonte në rihapjen e hetimeve.

11. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe për rrjedhojë edhe procesin e rivlerësimit për znj. Donika Prele në seancën e datës 5.2.2019, në të cilën subjekti ishte i pranishëm.

PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë *hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit*. Ata kanë të drejtë të çmojnë sipas bindjes së tyre të brendshme çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

13. Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë:

- a) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqëruar;
- c) Dokumente të tjera shkresore, përveç atyre që ka administruar DSIK-ja;
- ç) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga grupi i punës i Prokurorisë së Përgjithshme, së bashku me materialin shoqëruar;
- d) Dokumente shkresore, nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) Deklarimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- e) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si edhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht dhe në seancën dëgjimore;
- f) Gjetje të paraqitura në formën e një dokumenti, të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016;
- g) Denoncimet nga publiku.

A. VLERËSIMI I PASURISË

14. Subjekti i deklaramit, znj. Donika Prele, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33¹ të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

15. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konkluduar se:

- a) Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

16. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese

¹“Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaramet e pasurive, zhvillon procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative”.

nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.²

17. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Donika Prella, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

18. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat familjare ndër vite të cilat vinin nga paga e saj si prokurore dhe nga paga e bashkëshortit nga punësimi si inxhinier ndërtimi në disa shoqëri ndërtimi private, si dhe në disa institucione shtetërore. Këto të ardhura janë deklaruar rregullisht në deklaramet periodike vjetore dhe në deklarimin “Vetting”.

19. Sipas deklaramëve në DPV dhe “Vetting”, të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, janë:

- Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës në vitet 1999, 2000, 2001, pagesë burse dhe viti 2014 pagesë ekspertit, në shumën totale **506,780 lekë**;
- Të ardhura neto nga paga, nga puna si prokurore, që nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës nga viti 2001 deri në datë 30.11.2016 në shumën totale (neto) prej **13,210,369 lekë**;
- Të ardhura neto nga paga e bashkëshortit si i punësuar në Bashkinë Tiranë, nga viti 2011 deri në vitin 2016, në shumën 3,359,330 lekë;
- Të ardhura neto nga paga e bashkëshortit si i punësuar në Komunën ***, Durrës, në shumën totale 97,777 lekë;
- Të ardhura neto nga kontrata e punës si inxhinier ndërtimi, drejtues teknik në shoqërinë “***” sh.p.k për periudhën nga data 1.6.2011 – 25.4.2014, në shumën totale 901,030 lekë;
- Të ardhura neto nga puna e bashkëshortit si inxhinier në subjektin e ndërtimit “****” sh.p.k për periudhat e vitit 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008; 1.9.2010 - 31.12.2010 dhe viti 2011, **me shumë totale 3,810,000 lekë**.
- Të ardhura nga “****” për periudhën 1.7.2008-31.12.2009, në shumën prej 1,920,000 lekë.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me të ardhurat e krijuara

20. Në bazë të evidencave konstatohet se shtetasi V. P. ka qenë i punësuar për periudhën 2003-2008 dhe në shtator 2010 deri në vitin 2011, në shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k. Kjo marrëdhënie punësimi evidentohet nga deklaramet periodike në ILDKPKI dhe kontratat e punës, çka tregon se të ardhurat e përfituara për shtetasin V. P. gjatë kësaj periudhe janë nga një burim i ligjshëm dhe marrëdhënie pune konkrete.

21. Gjatë hetimit rezultoi se për këto të ardhura nuk ishin paguar të plota sigurimet shoqërore dhe tatimet për të gjithë periudhën e punësimit të z.V. P. në shoqërinë “****” sh.p.k.

²Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”

22. Instituti i Sigurimeve Shoqërore është shprehur se nuk ka të dhëna në sistem para viteve 2012, ndërsa në Drejtorinë e Arkivit Qëndror të Sigurimeve Shoqërore në Lundër rezultoi se nuk kishte të dhëna për shtetasin V. P.
23. Nga një dokument i Drejtorisë së Arkivit Qëndror të Sigurimeve Shoqërore në Lundër, të paraqitur nga subjekti, vërehet se për vitet 2006-2008 janë paguar pjesërisht sigurimet shoqërore.
24. Drejtoria Vendore e Tatim-Taksave Tiranë është shprehur se nga sistemi, për periudhën para datës 1.1.2012, nuk mund të japin informacion nëse shtetasi V. P. figuron i regjistruar në listëpagesat e ndonjë subjekti privat.
25. Komisioni i është drejtuar punëdhënësit, firmës “****” sh.p.k lidhur me pagesat e kryera për shtetasin V. P., i cili ka deklaruar se ka paguar atë në vlerën 50, 000 lekë (neto) në muaj për vitet 2003-2008 dhe 100.000 lekë (neto) në muaj për vitet 2010-2011, duke na dërguar një vërtetim. Ky vërtetim përputhej përkatësisht me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit DPV në deklarin “Vetting” si dhe kontratat e punës që ka dorëzuar bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.
26. Referuar nenit D pika 3 të Aneksit të Kushtetutës: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.”*
27. Për këto arsye, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova apo shpjegime të tjera për të bindur trupin gjykues mbi ligjshmërinë e të ardhurave nga pagat e bashkëshortit të saj, konkretisht: 101.000 lekë në vitin 2003; 159.000 lekë në vitin 2004; 150.000 lekë në vitin 2005; 420.000 lekë në vitin 2006; 228.000 lekë në vitin 2007; 300.000 lekë në vitin 2008; 400.000 lekë për vitin 2010 dhe 1.200.000 lekë për vitin 2011.
28. Subjekti paraqiti listëpagesat e kompanisë “****” sh.p.k. për vitet 2003, 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2008, në të cilat rezultoi se marrja e pagës nga bashkëshorti është bërë me arkën e shoqërisë.
29. Subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumentacion provues, listëpagesat e shoqërisë “****” sh.p.k **për vitet 2003 – 2005**, ku janë pasqyruar vlerat përkatëse të pagës bruto, detyrimet përkatëse tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore, si dhe paga neto që ka përfituar z.V. P. Listëpagesat ishin të konfirmuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe të shoqëruara me vërtetim të Drejtorisë së Arkivës Qëndror të Sigurimeve Shoqërore në Lundër, çka provon se shoqëria ka deklaruar të plota listëpagesat e punëmarrësve dhe ka paguar detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore përkatëse.
30. Paga neto e përfituar nga z.V. P. në vitet 2003, 2004 dhe 2005 përputhet me vlerat e deklaruara rregullisht në deklaratat periodike të këtyre viteve, si dhe në deklaratën “Vetting” nga subjekti.
31. Megjithëse nuk kishte një kontratë pune me shkrim për periudhën e punësimit gjatë viteve 2003-2005, konstatohet se mungesa e saj me shkrim nuk ka cenuar vlefshmërinë e marrëdhënies së punës, pasi ajo provohet nga të dhënat e administruara, që tregojnë se z. V.P. ka qenë i punësuar dhe është paguar nga subjekti “****” sh.p.k për llogari të punës së kryer prej tij në periudhën 2003-2005.
32. Subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumentacion provues, listëpagesat e shoqërisë “****” sh.p.k **për vitet 2006 – 2008**, nga ku rezultoi se pagesat janë bërë me pagë dyjavore neto, dhe se shoqëria ka paguar sigurime shoqërore dhe tatime vetëm për një pjesë të pagës mujore, duke e tatuar pjesërisht atë. Kjo shumë është paguar nga të ardhurat e vetë kompanisë.
33. Paga neto e përfituar nga z.V. P. në vitet 2006, 2007 dhe 2008 ishte sipas vlerave të deklaruara rregullisht në deklaratat periodike të këtyre viteve, si dhe në deklaratën “Vetting”.
34. Në kontratën e lidhur midis z.V. P. dhe shoqërisë “****” sh.p.k është parashikuar paga neto në masën 50,000 lekë në muaj, e cila rezultoi se faktikisht është marrë nga zoti P. sipas

marrëdhënies së punës, dhe se pagimi i sigurimeve shoqërore dhe i tatimit mbi të ardhurat ka qenë detyrim për t'u paguar për punëdhënësin, e cila rezultoi se është paguar pjesërisht prej tij. Kjo praktikë rezultoi e ndjekur për të gjithë të punësuarit në shoqërinë "****" sh.p.k. 35. Lidhur me marrëdhënien e punës të z. V. P. me firmën "****" sh.p.k për periudhën **shtator 2010 dhjetor 2011**, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion provues që provon se bashkëshorti i saj ka punuar në këtë periudhë në këtë kompani, duke paraqitur dokumentacionin teknik të firmosur nga ai, për periudhën shtator 2010 - dhjetor 2010 dhe janar 2011 - dhjetor 2011.

36. Nga hetimi rezultoi se mes z. V. P. dhe shoqërisë "****" sh.p.k ka pasur një marrëdhënie pune bazuar në kontratën e punës, e cila është deklaruar edhe në DPV përkatës dhe në deklarimin "Vetting". Në kontratën e punës është përcaktuar paga neto mujore, duke i ngarkuar punëdhënësit detyrimin për pagimin e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe detyrimet tatimore, porse punëdhënësi nuk i ka paguar detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe tatimet referuar pagës sipas kontratës së punës, duke u përpjekur t'i shmangi ato, pavarësisht se sipas kontratës së punës ai ka marrë përsipër t'i paguajë ato të plota.

Analiza e provave

37. Nenin D i Aneksit të Kushtetutës, parashikon disa kriteret për t'i konsideruar të ardhura të ligjshme. Trupë gjykues çmon se vlerësimi i ligjshmërisë së të ardhurave të shtetasit V. P. duhet bërë duke marrë në konsideratë këto fakte:

1. Të ardhurat e shtetasit V. P. rezultojnë të vijnë nga marrëdhënia e tij e punësimit dhe janë deklaruar rregullisht në DPV nga subjekti i rivlerësimit. Të dhënat në DPV përputhet me kontratën e punës për vitet 2006-2008 dhe vitet 2010-2011 dhe dokumentacionin provues ligjor të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, listëpagesat për vitet 2003 - 2008.

2. Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi punëdhënësi ka detyrimin dhe përgjegjësinë për pagimin e tatimit dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punëmarrësit. Punëdhënësi duhet t'i paguajë punëmarrësit pagën sipas dispozitave të kontratës.

Konkretisht: (i) Kodin e Punës, nenet 109, 110, 117, 121, (ii) neni 13 i ligjit nr. 7703/1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (iii) neni 6 dhe neni 8 i ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në fuqi në kohën kur pretendohet se duhet të ishin derdhur detyrimet për kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, (iv) ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (v) neni 10 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, (vi) udhëzimi nr. 5, datë 30.1.2006 i Ministrisë të Financave, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

• Në Kodin e Punës përcaktohet se:

- neni 109, "1. Me pagë kuptohet paga bazë, si dhe shtesat me karakter të përhershëm."

- neni 110, "1. Punëdhënësi i paguan punëmarrësit pagën sipas dispozitave të kontratës kolektive ose kontratës individuale, dhe në mungesë të tyre, punëdhënësi detyrohet të paguajë pagën e zakonshme për atë lloj pune të caktuar."

- neni 117, me titull "Zbritjet nga paga" përcaktohet se: "Punëdhënësi zbret nga paga e punëmarrësit tatimin mbi të ardhurat dhe kontributin e sigurimeve shoqërore shëndetësore të parashikuara me ligj, me akte nënligjore, me kontrata kolektive ose me kontrata individuale."

- neni 121, përcakton se: "1. Pranimi i përllogaritjes dhe arkëtimi i pagës, pa u kundërshtuar nga punëmarrësi, nuk quhet dorëheqje nga paga, nga një pjesë e saj ose nga shpërblimet që i takojnë."

• Në nenin 13 të ligjit nr. 7703/1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Kontributet do të paguhen nga personat e siguruar. 2. Kontributet e personave të punësuar nën një kontratë pune, do të ndahen ndërmjet personit të siguruar dhe punëdhënësit të tij, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe do të derdhen nga punëdhënësi. 3. Personat e detyruar për derdhjen e kontributeve janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tyre. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga e të punësuarve kontributet dhe t'i derdhë ato në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ose Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas fazave, që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Inspektorët e kontributeve të sigurimeve shoqërore kanë të drejtë të kontrollojnë në ndërmarrje, firma, institucione e subjekte të tjera ekonomike masat e kontributeve të derdhura, fondin e pagave dhe listëpagesat. 4. Çdo diferencë në shumën e kontributeve do të kthehen gjatë 5 vjetëve të pagesës së bashku me kamatëvonesën.”

• **Në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar**, në fuqi në kohën kur pretendohet se duhet të ishin derdhur detyrimet për kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore përcaktohet se:

- nenin 6 *“Detyrimet e personave që paguajnë kontributet”*

1. *Personi i detyruar për të paguar kontributet është përgjegjës për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve në kohën dhe në masën e duhur.*

2. *Punëdhënësi është përgjegjës për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit dhe për pagesën në organet tatimore, së bashku me kontributet e punëdhënësit.”*

- neni 8, *“Llogaritja e kontributeve për punëmarrësin”*

Kontributet e punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës, brenda një page bruto minimale që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe nivelit maksimal që është sa pesëfishi i pagës minimale.

• **Në ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar**, përcaktohet se:

- neni 10.2: *“2. Kontributi sipas germës “a” të pikës 1 të këtij neni është 3.4 për qind e pagës bruto, duke pasur si pagë minimale e maksimale atë të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për kontributet e sigurimeve shoqërore. Pagesa e këtij kontributi ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit.”*

- neni 11, *“Kontributet në fondin e sigurimeve shëndetësore paguhen çdo muaj. Afati i pagimit të kontributeve është jo më vonë se data 25 e muajit pasardhës. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga kontributin për të punësuarin dhe ta derdhë atë së bashku me kontributin e vet në organet tatimore ose në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ose Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas rastit, është përgjegjës për transferimin e kontributeve në Institutin e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor.”*

• **Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar**, përcaktohet:

- neni 8/a *“1. Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: a) pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës.”*

- neni 10, me titull *“Mbledhja e tatimit”*

“1. Çdo punëdhënësi, që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në gërmën “a”, të nenit 8 të këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë, të nenit 9, të këtij ligji dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës.”

• **Sipas udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se:**

- pika 2.6.1, *“Në zbatim të nenit 10, çdo punëdhënësi që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në gërmën “a” të nenit 8 të ligjit është i detyruar të llogarisë dhe të mbajë në*

burim tatimin mbi të ardhurat personale (të ardhurat nga punësimi), në përputhje me paragrafin e parë të nenit 9 të ligjit. Tatimi i mbajtur nga punëdhënësi duhet të derdhet në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës. Deklarimi dhe pagesa e këtij tatimi do të bëhet duke përdorur deklaratën “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, që i bashkëngjitet udhëzimit të ministrit të Financave për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Kjo deklaratë, e cila është njëkohësisht edhe deklaratë për efekte të detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dorëzohet në administratën tatimore sipas mënyrës së parashikuar në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.”

- pika 2.6.2, “Punëdhënësit detyrohen të bëjnë ndalesat në borderotë e pagave (listëpagesat), për efekt të tatimit mbi të ardhurat personale për pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me të ardhurat nga punësimi për çdo punonjës dhe llogaritja dhe mbajtja e tatimit pasqyrohen në formularët përkatës që i bashkëngjiten këtij udhëzimi dhe udhëzimit të Ministrit të Financave në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar.”

Vetë legjislacioni tatimor lejon pagimin e tatimit mbi të ardhurat në një kohë të mëvonshme, duke i shndërruar ato të ardhura në të ligjshme, apo proceseve të amnistisë së detyrimeve tatimore të papaguara (ligji nr. 39/2014; ligji nr. 66/2015, ligji nr. 33/2017).

3. Referuar kontratës së punës së firmosur nga shtetasi V. P., rezultoi se është përcaktuar paga neto dhe përgjegjësia ligjore për pagimin e taksave gjithashtu bie mbi punëdhënësin. Referuar legjislacionit në fuqi z. V. P. nuk mund të paguante personalisht tatimin mbi të ardhurat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore sipas kontratave të punës të datave 20.12.2005 dhe 25.8.2010.

4. Nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur është konstatuar se, mospagimi i tatimit mbi pagën dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore nga punëdhënësi, nuk ishte një problem vetëm për shtetasin V. P., por një dukuri për të gjithë punonjësit në shoqërinë “****” sh.p.k.

5. Në listëpagesat e punëdhënësit “****” sh.p.k për punëmarrësit përfshiheshin edhe pagesa e taksave dhe sigurimeve shoqërore. Kjo përforcon faktin se shtetasi V. P., ka qenë i keqinformuar nga punëdhënësi.

6. Gjatë hetimit u konstatua se shtetasi V. P. ka ndërmarrë hapa ligjorë lidhur me çështjen e mospagesave të taksave në momentin që ka marrë dijëni për këtë fakt.

Subjekti ka deklaruar se në muajin korrik 2018 kanë ardhur në dijëni të faktit se subjekti “****” sh.p.k ka patur një rast konflikti gjyqësor me një punonjës të saj, për shkak të mospagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën e viteve 2006, 2007 i cili ka fitur procesin gjyqësor me subjektin “****” sh.p.k.

Nisur ka ky konstatim, z. V. P. ka bërë kërkesë padi drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën ka paditur subjektin “****” sh.p.k duke kërkuar detyrimin e palës së paditur shoqëria “****” sh.p.k të paguajë në emër të paditësit në llogarinë e DRSSH-së Tiranë:

- Diferencën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimin mbi të ardhurat personale të papaguara për periudhën janar 2006 - dhjetor 2008, duke iu referuar pagës neto të pasqyruar në kontratën e punës të datës 20.12.2005, si dhe;
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimin mbi të ardhurat personale për periudhën shtator 2010 - dhjetor 2011, duke iu referuar pagës neto të pasqyruar në kontratën e punës të datës 25.8.2010.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit rezulton se çështja është ende në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

38. Komisioni verifikoi nëpërmjet analizës financiare të ardhurat e përgjithshme të subjektit të rivlerësimit ndër vite, e cila paraqitet sipas tabelës më poshtë.

*	Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	TOT (2003-2016)
Të ardhurat	717,824	904,650	778,369	1,006,814	1,215,877	1,684,706	2,229,325	1,045,854	1,274,227	1,944,321	1,554,016	2,138,331	4,510,465	2,035,625	23,040,404
Paga sub.rivl	600,608	760,794	618,529	826,814	843,477	652,016	877,325	908,684	989,558	962,403	977,208	1,225,915	1,126,548	1,195,108	12,564,987
Paga e BSh	117,216	143,856	159,840	180,000	372,400	982,690	1,200,000	0	284,669	981,918	576,808	894,416	783,917	813,517	7,491,247
E ardhur/patatar në pagën e BSh	0	0	0	420,000	227,600	337,310	0	400,000	1,200,000	0	0	0	0	0	2,584,910

39. Komisioni konstatoi se zoti P. ***nuk është përpjekur të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë*** në pronësi, pasi rezultoi e provuar se ai ***i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht ato***. Përputhen deklaratimet në deklaratën “Vetting” të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit me ato në deklaratimet e interesave periodike.

40. Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave konstatohet se shtetasi V. P. vërtetoi në mënyrë të pakontestueshme se marrëdhënia e tij e punësimit është e ligjshme dhe të ardhurat e përfituara kanë qenë nga një marrëdhënie pune e ligjshme. Mospagimi i taksave për një pjesë të të ardhurave në shumën totale prej 2,584,910 lekë ka qenë detyrim i punëdhënësit dhe se ato nuk mund të paguheshin nga vetë subjekti. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm faktin se nuk ka pasur dijeni për këtë praktikë të punëdhënësit dhe se bashkëshorti i saj nuk ka bashkëpunuar me punëdhënësin për të shmangur pagimin e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, porse ai ka qenë i dëmtuar nga ky proces.

41. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për mospagesat e detyrimeve përkatëse, dhe si rezultat, të ardhurat nga paga të marra ndër vite, do të merren në konsideratë në përlllogaritjen e mjeteve financiare të disponueshme në familjen e tij.

→ **Pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit të deklaruar në deklaratën “Vetting”**

42. **Apartament banimi me sipërfaqe 95.6 m²**, blerë sipas kontratës së porosisë të datës 3.5.2007, regjistruar në hipotekë me numër pasurie ***, datë 7.11.2012 në emër të bashkëshortit V. P., bazuar në kontratën e shitblerjes të datës 19.10.2012. Vlera e apartamentit sipas kontratës është 32,100 euro. Ky apartament është rivlerësuar nga subjekti i rivlerësimit në 30.7.2013 në vlerën 9,034,200 lekë.

43. Nga hetimi rezultoi çmimi i blerjes për këtë pasuri në vlerën prej 300 euro m² dhe vlera totale e blerjes është 32,100 euro. Janë kërkuar të dhënat nga ZVRPP-ja Tiranë lidhur me çmimin e shitjes së apartamenteve në këtë zonë. ZVRPP-ja Tiranë konfirmon se çmimi i referencës në vitin 2018 për apartamentet e ndodhura në pallatin ku ndodhet pasuria e subjektit të rivlerësimit është në vlerën 82,000 lekë/ m².

44. Lidhur me vlerën e blerjes së apartamentit, i cili duket si një çmim favorizues, u kryen disa hetime nga Komisioni.

45. U pyet shoqëria shitëse “****” sh.p.k për një informacion lidhur me çmimet e tjera të shitjes së apartamenteve në këtë objekt ndërtimor, në vitet 2007.

46. Shoqëria “****” sh.p.k ka kthyer përgjigje ku ka deklaruar se z.V. P. ka qenë punonjës i shoqërisë deri në vitin 2008 dhe për periudhën 2010 - 2011. Duke marrë në konsideratë kontributin e gjithsecilit punonjës, është aplikuar çmim më i ulët për disa punonjës të firmës, duke përfshirë dhe z. P. Firma “****” sh.p.k paraqiti gjithashtu disa kontrata të ngjashme, konkretisht:

- Pasuri me sipërfaqe 98 m² shitur në vitin 2014, z. D. B, në vlerën 2,900,000 lekë;
- Pasuri me sipërfaqe 88.5 m² shitur në vitin 2014, znj. E. M, në vlerën 26,550 Euro;
- Pasuri me sip.85 m² shitur në vitin 2012, z. D. L, në vlerën 4,400,000 lekë.

47. Ndërkohë shoqëria ka deklaruar se ka lidhur kontrata shitje nën çmimin e referencës edhe me persona të tjerë në objektin ku ndodhet pasuria e z. P., duke i referuar ato, konkretisht me shtetasit V. Z dhe E. Sh, përkatësisht në vlerat 5.000.000 lekë dhe 39.500 euro (me çmim më të ulët se ai i referencës).

48. Është pyetur lidhur me këtë pasuri edhe vetë subjekti i rivlerësimit, i cili ka deklaruar se ka blerë këtë apartament për një çmim prej 32.100 euro në vitin 2007 dhe se ky çmim është i tillë pasi ai ka blerë pallatin në vitin 2007 dhe se ky pallat është regjistruar në regjistrat hipotekor vetëm në vitin 2012. Çmimi ka qenë i tillë për faktin se bashkëshorti i subjektit ka punuar për disa vite në shoqërinë e ndërtimit dhe se kjo shoqëri ka dhënë apartamente me këtë çmim edhe për punonjës të tjerë të saj. Çmimi i referencës është një çmim që aplikohet kur pallati është i përfunduar dhe i regjistruar, ndërkohë që shtëpia është blerë në kohën kur pallati ishte në ndërtim, ende i papërfunduar.

49. Të ardhurat për krijimin e kësaj pasurie. Likuidimi i vlerës së apartamentit është bërë me dy mandatarkëtime të datës 3.5.2007 dhe datës 27.12.2007. Subjekti rivlerësimit ka deklaruar se burimi i të ardhurave ka qenë:

- a) shuma 27,100 euro, nga të cilat 12,100 euro (ose të konvertuar në lekë nga subjekti i rivlerësimit me kurs këmbimi 124 lekë/ euro, shuma 1,500,000 lekë) me burim të ardhurash nga kursimet e pagës deri në fund të vitit 2006, shuma 1,000,000 lekë dhe 500,000 lekë kursime nga paga deri më 3.5.2007;
- b) shuma 15,000 euro, hua djalit të xhaxhait të bashkëshortit, shtetasit S. (Gj.) P. Shtetasi S. (Gj.) P. i ka siguruar të ardhurat nga puna në emigracion në Greqi nga viti 1992 e në vazhdim, dhe pasuri të tjera të ligjshme të tij;
- c) shuma 5.000 euro (ose 600, 000 lekë) me burim të ardhurash nga pagat në vitin 2007.

50. Në deklaratën për vitin 2007 (DPV) është deklaruar “detyrime financiare” si hua e marrë për blerje apartamenti në shumën 15,000 euro, me kontratë verbale, pa interes, me afat 3 vjet. (marrë nga shtetasi Gj. S. P.).

51. Për të mbështetur ekzistencën e kësaj huaje si dhe aftësitë financiare të huadhënësit për të ofruar këtë shumë, subjekti ka paraqitur dokumentet e mëposhtme:

- Deklarata noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.2.2016, të shtetasit Gj. P., ku ai deklaroi faktin e dhënies dhe më pas shlyerjes së huas në shumën 15,000 euro, nga bashkëshorti V. P.;
- Deklaratat vjetore periodike për vitet 2007-2010;
- Deklarim mbi të ardhurat nga emigracioni të shtetasit Gj. P., bashkëlidhur me deklaratë me të dhëna të autoriteteve greke për pagimin e sigurimeve shoqërore të përkthyer në gjuhën greke, si dhe dokument numër unik të sigurimeve shoqërore që vërtetojnë punësimin në Greqi për disa periudha;
- Vërtetim lidhur me të ardhurat nga puna pranë Autoritetit Portual Durrës për vitet 2004-2007 në vlerën 1,326,000 lekë;
- Kontratë për shitblerje prone, me vlerë 1,000,000 lekë në vitin 2003.

52. Lidhur me shumën e dhënë hua në vlerën 15,000 euro, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie nga huadhënësi sipas nenit 32 pika 4 të ligjit nr. 84/2016.

53. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të dokumentuar mundësië e huadhënësit Gj. P. për dhënien e kësaj shume hua.

54. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime lidhur me të ardhurat e Gj. P. duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin provues.

54.1 Subjekti ka sqaruar se që në vitin 1996, Gj. P. ka hapur një llogari bankare pranë Bankës së Kursimeve, Durrës, sot Raiffeisen Bank. Për të vërtetuar këtë fakt, subjekti ka paraqitur një dokument, fotokopje libreze, depozitë bankare në Degën e Bankës së Kursimeve Durrës,

Agjencia bankare nr. ***, me depozitues Gj. P., numër depozite ***, depozitë me afat 3 muaj, lëshuar më datë 22.8.1996.

55. Për të vërtetuar faktin që shtetasi Gj. P. ka qenë në Greqi dhe ka punuar për rreth 10 vite, subjekti ka paraqitur këto dokumente:

A- Dokument i datës 8.1.2019 me nr. *** prot., të lëshuar nga sektori i të ardhurave aktivitete të përbashkëta, Dega Vendore e Punonjësve, Mesologji, Greqi, i marrë me vulë apostile dhe të përkthyer në gjuhën shqipe për shtetasin Gj. P., mbi njohjen e ditëve të siguruara në IKA për disa periudha;

B- Pasaportën me numër ***, në emër të Gj. P., lëshuar më datë 23.6.1993, ku në faqen nr. 9 të saj ndodhet viza greke 1- vjeçare, lëshuar më datë 25 mars 1994. Më datë 26 mars 1994 ka udhëtuar për në Greqi, përmes pikës së kalimit kufitar Kakavijë, referuar vulës dalëse po në faqen nr. 9 të pasaportës;

C-Pasaportën me numër ***, në emër të Gj. P., lëshuar më datë 23.8.1996 e vlefshme deri më datë 23.8.2001, ku në faqen nr. 5 të saj ndodhet viza greke 90-ditore, lëshuar më datë 2.9.1996; dalja nga pika kufitare e Kakavijës më datë 3.9.1996, referuar vulës dalëse po në faqen nr. 5 të pasaportës.

56. Përveç të ardhurave të siguruara nga emigracioni, shtetasi Gj. P.:

- disponon 5.000 m² tokë arë në ***, Durrës, që e ka përdorur dhe e përdor familjarisht për prodhime bujqësore, duke krijuar dhe të ardhura për mirëqenien e familjes (bashkëlidhur dokumenti i pronësisë);
- ai ka patur dhe të ardhura të tjera të siguruara nga puna pranë Autoritetit Portual Durrës, nga viti 2004-2007, në shumën prej 1,326,859 lekë;
- me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.04.2003, Gj. P. ka shitur një sipërfaqe toke në shumën 1,000,000 lekë.

57. Në seancë dëgjimore subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe një dokument të Raiffeisen Bank të datës 17.1.2019, i cili informonte se zoti Gj. P. ka qenë klient i Bankës së Kursimeve sh.a. Durrës dhe ka patur librezë kursimi me nr. ***, e cila është çelur më 22.8.1996 dhe është mbyllur më 10.12.2002. Banka ka informuar se është në pamundësi për të treguar gjendjen e depozitës në momentin e mbylljes së saj, por mund të konfirmojë faktin se në datë 31.12.1997 gjendja e depozitës ka qenë në shumën 2,464,131 lekë.

Analiza e provave

58. Mbështetur në shpjegimet e dhëna dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit Komisioni konstatoi se me vërtetimin nr. *** prot., datë 17.1.2019 të Raiffeisen Bank, shtetasi Gj. P. ka patur në bankë shumën prej 2,464,131 lekë.

59. Nëpërmjet dokumentacionit ligjor të paraqitur provohet se ai ka qenë në marrëdhënie pune në periudhën 2003-2007 dhe ka patur të ardhura në total në shumën prej 1,326,859 lekë.

60. Në datën 14.4.2003, Gj. P. ka shitur një tokë për të cilën ka marrë 1,000,000 lekë.

61. Mbështetur në këto dokumente të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues krijoi bindjen se shtetasi Gj. P. ka patur mundësi financiare nga burime të ligjshme për huan e dhënë në shumën prej 15,000 euro bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

62. Pagimi i shtëpisë sikurse rezulton është deklaruar i bërë në dy këste: 27.100 euro më datë 3.5.2007 dhe 5000 euro në dhjetor 2007. Nga dokumentacioni i administruar sa më sipër, subjekti ka patur të ardhura të ligjshme financiare për të blerë apartamentin në vitin 2007.

63. Të gjitha këto veprime rezultuan në përputhje me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të viteve 2006, 2007 dhe 2008.

64. Gjatë hetimit nëpërmjet pyetësorëve të dërguar subjektit të rivlerësimit janë deklaruar ndryshime në pasuri të paluajtshme, duke **shitur apartamentin me sipërfaqe 95.60 m² me vendndodhje në rrugën “***”, në vlerën 80.000 euro (tetëdhjetë mijë).**

- Shitja është realizuar në muajin prill të vitit 2018 me kontratën e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.4.2018, lidhur në zyrën e noterit H. Z. Vlera e shitjes së apartamentit është kaluar në llogarinë e noterit dhe më pas ai e ka transferuar shumën në llogari të z. P.
65. **Blerë apartament me sipërfaqe 135.90 m² me vendndodhje në rrugën “***”,** Tiranë me çmimin e blerjes 110.000 (njëqind e dhjetë mijë) euro, me kontratën e shitblerjes të vitit 9.7.2018, midis shtetasit V. P. (bashkëshortit) me cilësinë e blerësit dhe shtetasve F. H. dhe E. H. me cilësinë e shitësit.
66. Burimi për blerjen e apartamentit janë:
- a) Shuma prej 80.000 euro e përfituar nga shitja e apartamentit të vjetër e përfituar në llogarinë bankare të z. V. P., më datë 3.7.2018;
 - b) Shuma prej 30.000 euro është marrë nga llogaria bankare në emër të z.V. P., pranë BKT-së Tiranë.
67. Shuma në total prej 110.000 euro (njëqind e dhjetë mijë euro) është kaluar në llogarinë e noterit për blerjen e apartamentit më datë 12.7.2018.
68. Lidhur me këtë pasuri, në datën 18.1.2019, në Komision erdhi një denoncim nëpërmjet faqes së internetit i cili i'u dërgua edhe subjektit të rivlerësimit për dijeni.
69. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime më të detajuara lidhur me blerjen e kësaj pasurie nga shtetasit F. H. dhe E. H. me cilësinë e shitësit. Znj. Prela paraqiti edhe dokumentacion ligjor për të mbështetur shpjegimet e saj.
70. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se shtetasi F. H. është biznesmen, dhe se ai ka blerë tek firma e ndërtimit që në vitin 2014 disa pasuri të paluajtshme. Ai ka blerë këto pasuri kur pallati ka qenë në ndërtim dhe i ka shitur ato më vonë. Për të provuar këtë fakt subjekti paraqiti edhe kontratën e sipërmarjes me të cilën shtetasi F. H. kishte blerë apartamentin në vitin 2014 dhe i kishte likuiduar ndërtuesit edhe vlerën e plotë të saj.
71. Zonja Prela bëri transparencë të plotë të procesit të shitjes së apartamentit të saj ekzistues, duke paraqitur njoftimet/publikimet për shitje në gazetën “Çelësi” si dhe bërë të njohur të gjithë procesin e shitjes dhe marrjes së pagesës nga shitja e banesës së vjetër, apartament banimi me sipërfaqe 95.6 m², në Tiranë.
72. Nga shpjegimet e dhëna, dokumentacioni provues ligjor dhe verifikimi i kryer rezultoi se subjekti ka patur mundësi financiare për kryerjen e transaksionit për blerjen e shtëpisë, apartament me sipërfaqe 135.90 m² me vendndodhje në rrugën “***”, dhe se ato janë kryer në formën e rregullt ligjore.
73. **Tokë arë me sipërfaqe 1.000 m², me vendndodhje në *****, Tiranë, blerë me kontratën datë 31.1.2013, regjistruar në emër të bashkëshortit V. P.; vlera 350,000 lekë dhe pjesa takuese 50 % në bashkëpronësi me bashkëshortin.
74. ILDKPKI-ja është shprehur se vlera e blerjes së tokës arë me sipërfaqe 1,000 m², në shumën 350,000 lekë ose 350 lekë/m², është e dyshimtë, për faktin se zona është në zhvillim dhe me kërkesa për rritje të vazhdueshme prej vitesh.
75. Me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 31.1.2013, pranë noterit T.M, subjekti i rivlerësimit ka blerë një sipërfaqe prej 1.000 m² tokë bujqësore (arë) në ***, Tiranë nga shtetasit M. dhe L. D. Vlera e kësaj kontrate është 350,000 lekë. Më datë 8.2.2013 ZVRPP-ja Tiranë ka lëshuar certifikatë për vërtetim pronësie në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Blerja e kësaj pasurie është deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2013, pa deklaruar burimin e krijimit.
76. Komisioni bëri një verifikim të vlerave të tregut dhe çmimeve mesatare të shitjes në këtë zonë, nga ku rezulton se sipas vendimit nr. 514, datë 30. 7.2014 të Këshillit të Ministrave, çmimi për metër katror i tokës bujqësore në zonën e ***, Tiranë është 230 lekë/ m². Gjithashtu sipas vendimit nr. 187, datë 6.3.2013 të Këshillit të Ministrave, rezulton se çmimi për metër katror i tokës bujqësore në zonën e ***, Tiranë është 266 lekë/ m².
77. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “*Referuar periudhës kohore kur është blerë sipërfaqja e tokës 5 vjet e gjashtë muaj më parë, ky ka qenë çmimi i shitjes së tokës në zonë.*”

Sqaroj se sipërfaqja e tokës është tokë bujqësore (tokë arë), në një zonë në distancë rreth 3 km larg rrugës kryesore të asfaltuar, në zonë fshati, afër kësaj sipërfaqe toke nuk ndodhet ndonjë kompleks rezidencial me vila të ndërtuar nga ndonjë subjekt. Sqaroj se ky nuk është çmim preferencial, por është çmimi real me të cilin kemi blerë tokën.”

Subjekti bashkëlidhur dërgoi edhe printime të fotografisë ajrore të pozicionimit ku ndodhet sipërfaqja e tokës.

78. Referuar të dhënave nga aktet nënligjore lidhur me çmimet e tokës arë për këtë zonë kadastrale, (të dhëna të cilat përdoren si për kompesimin e pronave dhe për shpronësimet) vlera e blerjes nuk rezulton të këtë diferencë nga çmimet e referencës.

79. Pas verifikimeve rezulton se subjekti ka patur burime financiare për blerjen e kësaj pasurie. Përputhen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e mbledhur nga Komisioni.

80. Në deklaratën periodike për vitin 2014 është deklaruar shitje apartamenti me sipërfaqe 59.2 m² në Plazh, Durrës, në shumën 4,000,000 lekë, me kontratën datë 11.12.2014. Kjo është kontratë shitje me kusht kreditimi, shitje e cila është realizuar në 2015, pas përmbushjes së kushtit të kreditimit. Rezulton bashkëpronësia 50% pjesë takuese me bashkëshortin.

81. Apartament është blerë në vitin 2014 me vlerën prej 1,400.000 lekë dhe është shitur po në këtë vit në vlerën prej 4.000.000 lekë. Komisioni ka kërkuar të dhënat nga ZVRPP-ja Durrës lidhur me vlerat e kontratave të tjera të shitblerjes në këtë objekt, për ta krahasuar me kontratën e shitblerjes së subjektit të rivlerësimit.

82. ZVRPP-ja Durrës ka kthyer përgjigje, ku rezulton se shitësi ka shitur një apartament me sipërfaqe njësoj sa pasuria e subjektit të rivlerësimit prej 59.2 m² në vlerën prej 4,455,360 lekë. Pra, çmimi i shitjes së këtij apartamenti (sipas kontratës së porosisë) është ai i tregut.

83. Është kërkuar informacion nga shoqëria ndërtuese “***” sh.p.k, e cila sqaron se çmimi i shitjes është përcaktuar me marrëveshje verbale midis palëve dhe se çmimi është vendosur i tillë për shkak se z. P. ka punuar si inxhinier ndërtimi, drejtues i kantierit për zbatimin e punimeve në objektin ku ndodhet pasuria. Shoqëria “***” sh.p.k ka informuar se ka aplikuar çmim të ulët në të njëjtin objekt dhe për financieren e shoqërisë “***” sh.p.k, duke lidhur kontratë në vitin 2015 për shitje apartamenti me sipërfaqe 53.8 m² në shumën prej 12,000 euro.

84. Apartamenti është shitur me kontratën me kusht në datë 11.12.2014, në shumën 4,000,000 lekë, depozituar në emër të noteres, e cila i ka kaluar më 24.2.2015 me përshkrim “transfertë sipas kontratës nr. ***, datë 11.12.2014”, në llogari bankare të V. P.

85. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se përputhen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e mbledhur gjatë hetimit. Nga analiza financiare rezultoi se ajo ka patur burime financiare të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti.

→ **Pasuri të Luajtshme**

86. Volkswagen Golf blerë në shumën 400,000 lekë sipas kontratës së shitjes më datë 4.4.2012. Burimi i krijimit është nga shitja e një automjeti Volkswagen Golf, në pronësi të bashkëshortit në vlerën 400,000 më datë 28.3.2012, automjet i blerë në vitin 2008 në shumën 500,000. Burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit të fundit ka ardhur nga shitja e një automjeti më parë, tip “Benz”, më datë 16.5.2008, në shumën 300,000 dhe diferenca prej 200,000 lekë nga kursimet nga paga.

87. Nga hetimi dhe të dhënat e marra nga DPSHTRR-ja nuk rezultojnë pasaktësi. Dokumentacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së dhe Komisionit, përputhet me deklaratimet në deklaratën “Vetting” dhe me deklaratën periodike vjetore. Nga analiza ekonomike rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka patur burime financiare për blerjen e këtij automjeti.

88. Automjet tip “Daimler Chrysler” regjistruar në emër të z.V. P. Mjeti është blerë më datë 15.1.2012 në vlerën 6,500 euro dhe burimi i krijimit është nga kursimet nga pagat.

89. Nga hetimi dhe të dhënat e marra nga DPSHTRR-ja nuk rezulton pasaktësi mbi këtë pasuri. Dokumentacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së dhe Komisionit përputhet me deklaratimet në deklaratën “Vetting” dhe me deklaratën periodike vjetore. Nga analiza ekonomike rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka patur burime financiare për blerjen e këtij automjeti.

90. Kompania “****”. Është deklaruar në formularin “Vetting” krijimi i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, “****”, me objekt në fushën e ndërtimit, krijuar më datë 7.7.2008, Tiranë, dhe regjistruar në regjistrin themeltar më 18.8.2008, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

91. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë ka dërguar informacion mbi aktivitetin e shoqërisë tregëtare “****” sh.p.k, sipas të cilës rezulton se shoqëria për disa vite ka dalë me humbje. Ajo është likuiduar dhe më tej ç`regjistruar.

92. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kompania ashtu sikurse është deklaruar, është kaluar në status pasiv nga bashkëshorti në vitin 2013 dhe ky vit është nënkuptuar nga ana e tij si mbyllje e aktivitetit, ndërsa është çregjistruar më datë 26.12.2018. Subjekti ka paraqitur ekstraktin e QKR-së me shënimet përkatëse.

93. **ILDKPKI-ja në përfundim të veprimeve verifikuese ka konstatuar mosdeklarim të një huadhënieje në shumën totale 25,000 euro** nga bashkëshorti V. P., në deklaratën e interesave private periodike vjetore, 2011, dhe kthimit të shumës në deklaratën e interesave private periodike vjetore, 2014.

94. Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit në lidhje me kontratën e huas datë 22.9.2011, me të cilën i është dhënë një hua shtetasit R. N. në shumën 25,000 euro, si dhe një deklaratë noteriale datë 20.9.2011, për shumën 10,000 euro, sesa ka qenë shuma totale dhënë jua shtetasit R. N. dhe burimin e këtyre fondeve, si dhe mënyrën e likuidimit (me bankë apo *cash*), duke i kërkuar bashkëlidhur dokumentacionin përkatës.

95. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se V. P. ka deklaruar se i ka dhënë shtetasit R. N. gjithsej shumën prej 25,000 euro, në dy këste (10,000 euro dhe 15,000 euro), të marrë nga kushëriri i tij z. A. P. V. P. ka ndjekur kthimin e kësaj huaje, së bashku me interesat, nga shtetasi R. N. tek shtetasi A. P., deri në qershor të vitit 2014. Ai e ka kryer këtë veprim në emër të kushëririt të tij A. P., pasi ky i fundit nuk jetonte në Shqipëri. Këto veprime, zoti V. P., i ka kryer me prokurën e posaçme të datës 15.7.2011, të deklaruar edhe në DPV përkatës.

96. Po ashtu është deklaruar dhe dokumentuar nga hetimi se shtetasi A. P. ka patur burime financiare të mjaftueshme dhe nga burim i ligjshëm për dhënien e kësaj huaje shtetasit R. N. (administrator i shoqërisë tregëtare “****” sh.p.k) ku z.V. P. ka qenë i punësuar.

97. Huadhënia nuk është deklaruar, pasi nuk ka qenë pjesë e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

→ **Mjetet Financiare**

98. Llogari bankare në BKT, në shumën 4.501.428 lekë në emrin e bashkëshortit z.V. P. Burimi janë të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 59.2 m² në lagjen ***, Plazh, Durrës dhe kursimet nga paga e të dy bashkëshortëve, gjatë viteve të depozituara në bankë në 29.2.2016. Apartamenti është shitur me kontratën me kusht në datë 11.12.2014 në shumën 4,000,000 lekë, depozituar në BKT në emër të V. P. Apartamenti është blerë nga V. P. me kontratën e shitjes datë 22.2.2014 në shumën 1,400,000 lekë dhe vlera e këtij apartamenti është përcaktuar nga shoqëria “****” sh.p.k, vërtetuar me vërtetimin datë 23.2.2016 dhe i regjistruar në ZVRPP-në Durrës me certifikatën nr. ***, datë 20.3.2014. Më datë 23.1.2017, BKT-ja konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka në llogari bankare vlerën prej 4,501,427.89 lekë.

99. Janë verifikuar veprimet bankare të kalimit të shumës nga shitja e apartamentit dhe burimet e tjera të krijimit. Nga të dhënat e mbledhura nuk rezultoi ndonjë problematikë për këtë llogari bankare dhe rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë.

100. Gjendja e llogarisë bankare e cila më datë 31.12.2017 ka qenë në shumën prej 4,504,594,68 lekë, (katër milion e pesëqind e katër mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër lekë) ka pësuar ndryshime në vitin 2018.

101. Më datë 6.7.2018, nga gjendja e kësaj llogarie bankare është bërë konvertimi në shumën 30,000 euro, nga shuma prej 3,784,500 lekë, nga z.V. P. Kjo shumë është përdorur për blerjen e një apartamenti të ri. Më datë 6.7.2018, kjo llogari është mbyllur si llogari kursimi dhe ka kaluar në llogari rrjedhëse bashkë me pagat e z. V. P. Nga kjo llogari ka mbetur shuma prej 722,319 (shtatëqind e njëzet e dy mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë, pas tërheqjes së shumës prej 30.000 euro.

102. Nga hetimi dhe të dhënat e marra nga Banka Kombëtare Tregtare, nuk rezultojnë pasaktësi, dokumentacioni i administruar në dosje, përputhet me deklaramet në deklaramtën “Vetting” me deklaramtën periodike vjetore dhe deklaramet e subjektit të rivlerësimit gjatë komunikimeve elektronike.

103. Llogari rrjedhëse për pagën e subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank nga viti 2001 – 2016, ku gjendja më datë 23.1.2017 në shumën 8, 257 lekë. Burimi janë deklaramtë të ardhurat e pagës si prokurore.

104. Llogari bankare në emër të vajzës në Bankën Credins Tirana, ku gjendja më datë 27.12.2016 rezultoi në shumën 27,000 lekë. Burimi është deklaramtë si “dhënie stimuli si nxënëse me rezultate”.

105. Llogari rrjedhëse e pagës së bashkëshortit në Credins Bank në shumën 147,903 lekë gjendje, më datë 20.1.2017.

106. Nga hetimi në tërësi i kryer nga Komisioni dhe të dhënat e marra nga sistemi bankar nuk rezultojnë dyshime mbi burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive. Dokumentacioni i administruar në dosjen përputhet me deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaramtën “Vetting” dhe me deklaramtën periodike vjetore.

107. ILDKPKI³ - Mosdeklaramtë i huamarrjes në shumën 1,000,000 lekë ndaj shtetasit Gj. P., për efekt të pajisjes me vizë, në deklaramtën e interesave private periodike vjetore, 2010.

108. Huaja private në shumën 1,000,000 lekë është marrë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit z. V. P. nga djali i xhaxhait të tij Gj. P., më datë 2.6.2010, me qëllim depozitimin në bankë për shkak të aplikimit për vizë amerikane. Shuma është depozituar më datë 3.6.2010 nga bashkëshorti pranë Bankës Kombëtare Tregtare, Tiranë, ku është pajisur dhe me vërtetimin me nr. *** prot., datë 3.6.2010 lëshuar për Ambasadën Amerikane. Kjo shumë është tërhequr më pas nga banka në dy këste, më datë 7.6.2010 dhe datë 9.6.2010 dhe është kthyer shtetasit Gj. P. nga ana e bashkëshortit të subjektit.

109. Për sa i përket mosdeklaramtës në formularin e pasurisë të vitit 2010, referuar ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklaramtin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, në fuqi në vitin 2010, si dhe sipas përcaktimit ligjor në faqen nr. 5 të formularit të deklaramtës periodik të pasurisë, është vlerësuar se nuk ka qenë e nevojshme kryerja e këtij deklaramti, sa kohë që më datë 31.12.2010 nuk ka patur detyrim të pashlyer ende.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë.

110. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e transparencës, procesit të rregullt ligjor, eficiencës, proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, arrin në përfundimin se:

³ Kapaciteti financiar dhe ligjshmëria e të ardhurave të huadhënësit Gj. P. janë hetuar dhe analizuar nga ky trup gjykues përgjatë këtij vendimi.

“Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin me burime financiare të ligjshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezultojnë të jetë të ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.”

B. VLERËSIMI I FIGURËS

111. DSIK-ja në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. ***, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe nenin 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar më datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht, *ku konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit znj. Donika Prela.*

112. Me kërkesë të Komisionit, është përcjellë përditësimi i të dhënave nga organet ligjzbatuese për këtë subjekt rivlerësimi, përkatësisht me shkresat e muajit nëntor 2018.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

113. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjyqësor, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit i) deklaratën për kontrollin e figurës; ii) raportin e DSIK-së, iii) informacione nga organet ligjzbatuese; iiiii) si dhe zhvilloi një hetim të thelluar kryesisht, bazuar në parimin e transparencës, procesit të rregullt ligjor, eficiencës, barazisë së palëve në procesin gjyqësor, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të figurës, arrin në përfundimin se: *Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që ai të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë ajo është e përshtatshme për vazhdimin e detyrës.*

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

114. Prokuroria e Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* dhe në ligjin nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, ka bërë vlerësimin profesional sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016 dhe ka paraqitur raportin përkatës.

115. Nga shqyrtimi i 5 dosjeve ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ka përpiluar dhe nënshkruar çështjen e arrestimit dhe vlerësimit në flagrancë të shtetasit G. K. (çështja penale nr. ***). Në vijim është kërkuar pranë gjykatës caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal.

116. Po kështu, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka ndjekur çështjen penale me të pandehur shtetasin V. S., për veprën penale të “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal (procedimit penal nr. *** i vitit 2014). *Në vijim nuk është vleftësuar masa e arrrestit në gjykatë sipas nenit 258 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë rast i dyshuari është liruar dhe çështja e tij i është dërguar gjykatës tre muaj pas kohës së arrestimit.*

117. Nisur nga fakti se të 2 çështjet e mësipërme kanë pasur për objekt të njëjtin referim për veprën penale atë të drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt, vërehet se janë ndjekur 2 standarde të ndryshme në lidhje me veprën penale (neni 291 i Kodit Penal), edhe pse procedura dhe rrethanat paraqiten të ngjashme. Komisioni vëren se janë aplikuar dy standarde të ndryshme në lidhje me vërtetimin e legjitimitetit të arrestit si dhe kërkesës për burgim.

→ **SHPJEGIME të subjektit:**

118. “Në lidhje me konstatimin e Komisionit se nga ana ime janë ndjekur dy standarde të ndryshme në trajtimin e dy rasteve të njëjta, sqaroj se ky konstatim nuk qëndron.

119. Referuar akteve të procedimit penal nr. *** shtetasi G. K. rezulton se është arrestuar nga policia gjyqësore me procesverbalin e datës 6.6.2015, ora 21.00, për veprën penale të “Drejtimin të mjetit në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Arrestimi i tij është bërë pasi referuar procesverbalit të datës 6.6.2015 ora 19.51, pas verifikimit të përdorimit të alkolit, ai është kapur në flagrancë, duke drejtuar mjetin motorik në gjendje të dehur. (nga aktet ka rezultuar se ky shtetas nuk posedonte dhe leje drejtimi).

120. Shtetasi V. S. referuar akteve të procedimit penal nr. *** është referuar nga policia për hetim në gjendje të lirë për veprën penale të “Drejtimin të mjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, pasi sipas procesverbalit të kapjes në flagrancë të këtij shtetasi, datë 27.06.2014, ora 12.15, ai është kapur duke drejtuar mjetin motorik pa leje drejtimi.

121. Standardi i dyfishtë në këtë rast është ndjekur nga policia dhe jo nga ana ime si prokurore, pasi shtetasin G. K. e kanë sjellë për hetim të arrestuar, ndërsa shtetasin V. S. në gjendje të lirë. Procesverbali i kapjes në flagrancë, të cilit ju i referoheni në rastin e shtetasit V. S. është një akt procedural i përdorur nga policia, që bazohet në nenin 252 të K.Pr.Penale. Neni 258 i K.Pr.Penale parashikon që prokurori paraqet kërkesë për vlerësimin e arrestimit në flagrancë (jo paraqet kërkesën për vlerësimin e kapjes në flagrancë) brenda 48 orëve nga arrestimi i tij. Arrestimi në flagrancë pasqyrohet në procesverbalin e arrestimit në flagrancë që mban policia dhe jo në procesverbalin e kapjes në flagrancë. Kështu neni 251 i K.Pr.Penal me titull “ Arrestimi në flagrancë” parashikon se:

1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore **kryejnë detyrimisht** arrestimin e cilitdo që **kapet në flagrancë** për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet.

2. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore **kanë të drejtë** të arrestojnë cilindo që **kapet në flagrancë** për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur nëtentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet ose për një vepër penale të kryer nga pakujdesia, për të cilën ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dhjetë vjet.

3. Kur lind nevoja e domosdoshme, për shkak të rëndësisë së faktit ose të rrezikshmërisë së subjektit, e motivuar me akt të veçantë, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që **kapet në flagrancë**, edhe kur nuk janë kushtet e pikës 2.

4. Në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, çdo person është i autorizuar të kryejë arrestimin në flagrancë për krimet që ndiqen kryesisht. Ai që ka kryer arrestimin duhet të dorëzojë menjëherë të arrestuarit në policinë gjyqësore, e cila mban procesverbal për dorëzimin dhe i jep një kopje të tij.

122. Po kështu neni 252 i K.Pr.Penale me titull “Gjendja e flagrancës” përcakton në mënyrë shteruese rastet se kur një person konsiderohet se është në gjendje flagrance si më poshtë:

“Eshtë në gjendje flagrance ai që është kapur: (1) në kryerje e sipër të veprës penale ose (2) ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë, ose (3) që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.

123. Kjo do të thotë se për të pasqyruar gjendjen e flagrancës, policia përpilon procesverbalin e kapjes në flagrancë të personit, i cili nuk është i njëjtë me procesverbalin e arrestimit në flagrancë të tij, që do të thotë se një person mund të kapet në flagrancë për kryerjen e një vepre penale, dhe në varësi të rëndësisë së faktit (referoju nenit 251 të sipërcituar), mund të arrestohet në flagrancë ose jo nga policia.

124. Kjo ka ndodhur në rastin e shtetasit V. S, pasi policia ka kryer kapjen e tij në flagrancë, duke e pasyruar në procesverbalin e kapjes në flagrancë, por nuk ka kryer arrestimin në

flagrancë të tij. Në këtë rast personi është sjellë për ndjekje penale, për fillim të hetimeve në gjendje të lirë dhe jo i arrestuar gjë që do të sillte detyrimin tim si prokurore për t'iu drejtuar gjykatës me kërkesë për vlerësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit sikurse kërkon neni 258 i K.Pr.Penale ose të vlerësoja të paligjshëm arrestimin në flagrancë të personit dhe të urdhëroja lirimin e tij të menjëhershëm, bazuar në nenin 257 të K.Pr.Penale.

125. Sa më sipër, rezulton se në rastin konkret nuk janë zbatuar standarde të ndryshme për raste të ngjashme, pasi për shtetasin V. S. nuk gjen zbatim dispozita e nenit 258 të K.Pr.Penale.

126. Në përfundim, nga vlerësimi i tri dosjeve të zgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dokumenteve ligjore të përzgjedhur me short për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, rezulton se gjuha e përdorur nga subjekti Donika Prea në aktet procedurale të kryera prej saj është në përputhje me rregullat e pranura të etikës profesionale të prokurorit. Po kështu, në asnjë prej praktikave, të cilat përfshihen në dosjet e përzgjedhura, nuk rezultojnë ankesa në drejtim të veprimeve dhe akteve të kryera prej subjektit.

Nga gjetjet në procedimet penale të shortuara, rezulton se subjekti ka administruar në mënyrë të shpejtë dhe efikase ngarkesën e punës që i është caktuar.

Në lidhje me vlerësimin e paanësisë për subjektin Donika Prea, nuk rezulton të ketë patur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar, apo të ketë pasur cenim të të drejtave të pjesëmarrësve në proces dhe grupeve shoqërore të tjera.

Nga verifikimi pranë sektorit të burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, ndaj subjektit Donika Prea nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Në lidhje me vlerësimin e etikës në punë, nga vlerësimet e punës së subjektit Donika Prea për vitet 2014, 2015, 2016, bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se ajo është vlerësuar “shumë mirë”, për etikën profesionale.

127. Bazuar në disa fakte publike, të botuara në gazetë, është kërkuar pranë Prokurorisë Durrës për vënien në dispozicion të një praktike lidhur me procedimin penal të shtetasit L.R. Prokuroria e Durrësit ka dërguar dosjen e plotë lidhur me këtë procedim penal. Sipas hetimit të kryer nga Komisioni mbi këtë dosje rezulton se në përgjithësi subjekti i rivlerësimit ka ndjekur veprimet hetimore dhe ka kryer hapat proceduralë të kërkuar nga ligji.

128. Nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) i është kërkuar znj. Donika Prea, informacion lidhur me veprimtarinë ligjore të saj si drejtuese e Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, mbi vendimmarrjen në administrimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve E. Sh, G. D, etj., të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga nenet 109/b, 333/a dhe 334, e vijues të Kodit Penal në periudhën maj-tetor 2018.

129. ONM-ja i ka përcjellë trupit gjykues të gjithë dokumentacionin për këtë çështje, së bashku me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni nuk kanë rezultuar elementë të dyshimtë lidhur me këtë proces.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

130. Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë”.

131. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

132. Nga informacioni i ardhur nga publiku deri në mbylljen e hetimeve nga Komisioni, rezultuan 2 denoncime, të cilat i janë vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit dhe ajo ka dhënë shpjegimet e veta.

- Denoncimi nga z. I. M., i cili nuk është paraqitur në formën dhe standardin e denoncimeve, por në formën e kallëzimit penal, dhe
- Denoncimi 2, përcjellë nga Kolegji i Apelit me shkresë “Informacion” i z.V. Ç.

→ **Shpjegime të subjektit të rivlerësimit**

“Në lidhje me kallëzimin penal të bërë nga shtetasi I. M., Prokurorisë Durrës, të dërguar për dijeni dhe Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit, rezultoi se më datë 11.11.2013 shtetasi A. B. ka paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës kallëzim penal për shtetasin Z. Gj. për veprat penale të “Mashttrimit”, “Ndërtim pa leje” dhe “Pushtimit të tokës”, të parashikuar nga nenet 143, 199/a dhe 200 të K.Penal. Në kallëzim, si dhe në shpjegimet që i janë marrë shtetasit A. B., ky shtetas ka deklaruar se babai i tij, shtetasi K. B., i ka shitur shtetasit Z. Gj. për shumën 1.450.000 lekë sipërfaqen 22 dynym tokë arë, dhe 5.5 dynym vreshtë.

Shitja e tokës nga babai sipas kallëzuesit ishte bërë pa miratimin e pjestarëve të tjerë të familjes, dhe po kështu marrja e firmës duhet të jetë bërë ose me mashttrim ose në gjendje të dehur, pasi babai i tij, pinte shumë. Mbi sa më sipër, nga ana e Oficerit të Policisë Gjyqësore të caktuar nga ana ime për kryerje të veprimeve hetimore, është pyetur dhe shtetasi Z. Gj. Ky shtetas ka mohuar akuzat dhe ka dorëzuar para policisë dokumentet: aktmarrëveshje datë 2.2.1996, të vërtetuar nga noteri me nr. *** rep., nr. *** kol., ku shtetasi K. B. jep në përdorim për 30 vjet pasuritë e tij sipas marrëveshjes, dhe vlera e qirasë së paguar për 30 vjet konsiderohet vlerë e blerjes së pasurive; deklaratë për dhënie dhe marrje toke në dorëzim, po të vërtetuar nga noteri datë 26.8.1995, të firmosur nga të gjithë familjarët, etj.

Nisur nga fakti se si në kallëzim ashtu dhe në shpjegimet e dhëna A. B. ka pretenduar se babai i tij i ka shpjeguar se nuk ka firmosur, por dhe nëse ka firmosur në aktmarrëveshje, ka qenë në gjendje të dehur ose është mashtroar, nga ana ime më datë 13.12.2013 është vendosur mosfillimi i hetimeve, me arsyetimin se kryerja e një veprimi juridik me ves, mashttrim ose në gjendje të dehur sikurse është pretenduar, nuk përbën veprë penale, por duhet të zgjidhet në rrugë civile në gjykatë.

Më datë 24.1.2014, avokati I. M., me prokurë, ka kërkuar kopje të akteve të materialit kallëzues me nr. *** të vitit 2013, akte të cilat i janë vënë në dispozicion më datë 29.1.2014. Me marrjen e kopjeve të akteve, më datë 30.1.2014, shtetasi A. B. ka bërë përsëri kallëzim në prokurori ndaj shtetasit Z. Gj., por këtë radhë për veprën penale të “Fallsifikimit të dokumenteve” të parashikuar nga neni 186 i K.Penal, të kryer në formën e përdorimit të dokumenteve të falsifikuara”, pikërisht gjatë verifikimeve të kryera në materialin kallëzues të hetuar nga ana ime.

Ky kallëzim penal është caktuar fillimisht për hetim prokurorit A. Sh., i cili ka konstatuar faktin e marrjes së një vendimi të mëparshëm nga ana ime, dhe ka bërë kërkesë për heqje dorë nga hetimet, kërkesë e cila i është pranuar nga drejtuesi, duke më kaluar përsëri kallëzimin e ri për hetim. Nga ana ime, menjëherë, pasi jam njohur me këtë pretendim të ri, dhe tashmë konkret për firma të subjekteve nënshkruese të falsifikuara dhe për përdorim të akteve të falsifikuara në materialin kallëzues nr. *** të vitit 2013, të dorëzuara përpara oficerit të policisë gjyqësore nga shtetasi Z. Gj., më datë 13.2.2014 kam regjistruar procedimin penal nr. *** datë 13.2.2014, për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

Në kohën që dosja ka qenë në hetim nga ana ime si prokurore, më datë 18.4.2014, kallëzuesi ka bërë kërkesë drejtuar drejtuesit të Prokurorisë, për zëvendësimin tim nga hetimi, duke pretenduar njëanshmëri në hetim nga ana ime me shkaqe të cilat nuk qëndronin, deri tek përkatësia e njëjtë fetare e imja me personin e kallëzuar. Në situatën e krijuar pasi jam njohur më kërkesën, më datë 21.4.2014, kam bërë dorëheqje nga hetimi, kërkesë e cila është pranuar nga drejtuesi me vendimin e datës 24.4.2014. Kjo dosje më pas është hetuar nga prokurori

A.Sh., i cili në përfundim të hetimeve ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Dua të theksoj se nga praktika ime shumëvjeçare, veprime si ato të zotit I.M., janë taktika të palëve për të eliminuar shpenzime gjyqësore që kërkon kryerja e ekspertizave grafike të shkrimeve dhe nënshkrimeve të dokumentet të caktuara ose në kontrata, shpenzime të cilat sipas legjislacionit shqiptar, paguhen nga shtetit në rastin e çështjeve penale, dhe nga vetë subjektet në rastet e padive civile. Edhe prokurori tjetër që ka zhvilluar hetime, ka konstatuar fallsifikimin e dokumenteve dhe ka vendosur pushimin e hetimeve, me asrjetimin se janë parashkruar afatet e ndjekjes penale, referuar faktit se dokumentet i përkasin periudhës së viteve 1995 dhe 1996.

Në përfundim, ajo çfarë mund të them në lidhje me sa më sipër, është se vendimarrja ime fillestare për mosfillimin e hetimeve me shkakun se pretendimet duhet të zgjidhen në rrugë gjyqësore civile, ka qenë plotësisht e ligjshme, referuar pretendimeve fillestare të kallëzuesit (se firma mund t'i jetë marrë babait me mashtrim apo në gjendje të dehur pasi ai pinte shumë, babai i kallëzuesit kishte vdekur në vitin 1998). Subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe dokumentacionin ligjor përkatës.

Në lidhje me ankesën e shtetasit V. Ç., sqaroj se nga verifikimet që bëra në zyrën e protokollit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, rezultoi se shtetasi V. Ç., më datë 5.6.2018 ka paraqitur në protokoll kërkesën për informacion që më është drejtuar mua me cilësinë e drejtueses, protokolluar në hyrje me nr. *** prot., në të cilën kërkon informacion për emrin e prokurorit që po ndjek çështjen e tij, me qëllim për të paraqitur dokumente të tjera shtesë në lidhje me kallëzimin e bërë prej tij.

Rezultoi se kjo shkresë, nuk më është vënë mua në dispozicion nga sekretaria, pasi nuk ka shënim timin në këtë kërkesë për përcjellje apo informacion nga prokurori i çështjes, por gjendej në dosjen penale me nr. ***, datë 18.6.2018, regjistruar për veprën penale të “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të parshikuar nga neni 319/ ç i K.Penal. Ky procedim është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasit V. Ç., të dërguar për kompetencë me shkresën me nr. *** prot, datë 28.05.2018 të Prokurorisë së Përgjithshme.

Ajo që unë konstatova është fakti se, megjithëse unë si drejtuese nuk kisha ardhur në dijeni të kërkesës për informacion të shtetasit V. Ç., dhe kësaj kërkesë nuk i është kthyer përgjigje formalisht, rezultoi se ky shtetas (ankuesi), më datë 14.6.2018 është pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore të ngarkuar me hetimin e dosjes, dhe referuar këtij procesverbali, ai ka deklaruar se nuk mund të japë shpjegime për shkaqe shëndetësore.

Sa më sipër rezultoi se, megjithëse ankuesi nuk ka marrë përgjigje në rrugë zyrtare nga ana ime, ai ka marrë dijeni efektivist, pasi është thirrur dhe është pyetur në prokurori në lidhje me kallëzimin e tij. Ka patur dijeni se kush po bën hetim në lidhje me kallëzimin, një javë pasi ka bërë kërkesën (datë 5.6.2018- kërkesa dhe datë 14.6.2018- pyetja e tij), pra, ka patur dijeni efektivist për prokurorin dhe nuk i është mohuar asnjë e drejtë procedurale në lidhje me procedimin penal.

Sa më sipër, subjekti ka vënë në dispozicion vendimin e regjistrimit të procedimit penal nr. ***, datë 18.6.2018, si dhe kopje të akteve që ndodhen në këtë dosje, kërkesa për informacion datë 5.6.2018 e shtetasit V. Ç, si dhe procesverbali i pyetjes së shtetasit V. Ç, datë 14.6.2018.

133. Pas mbylljes së hetimeve, në Komision ka mbërritur në rrugë elektronike në datën 3.1.2019, një denoncim i ri për subjektin e rivlerësimit znj. Donika Prela. Ky denoncim i është përcjellë për njohje, subjektit të rivlerësimit, në datën 3.1.2019.

134. Nga verifikimi i përmbajtjes së denoncimit rezultoi se të gjitha informacionet e përfshira në atë denoncim ishin trajtuar nga Komisioni gjatë hetimit të zhvilluar për subjektin e rivlerësimit.

135. Pasi subjekti ka dorëzuar rezultatet e hetimit, në datën 17.1.2019 është njoftuar për seancën dëgjimore, ndërkohë në Komision në datën 18.1.2019, ka ardhur një denoncim i ri në rrugë elektronike, i cili po në datën 18.1.2019 i është përcjellë për njohje, subjektit të rivlerësimit.

136. Nga verifikimi i përmbajtjes së denoncimit, rezultoi se të gjitha informacionet e përfshira në atë denoncim ishin trajtuar nga Komisioni gjatë hetimit të zhvilluar për subjektin e rivlerësimit.

137. Në datën 28.1.2019, anëtarët e trupit gjykues u informuan lidhur me disa lajme që qarkulluan në media mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit znj. Donika Prella në një dosje hetimore. Diskutimet lidhur me këto lajme bënë të pamundur marrjen e një vendimi përfundimtar nga trupi gjykues, pasi u vlerësua se verifikimi i informacionit mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në një dosje hetimore, ishte i rëndësishëm për procesin e vendimmarrjes.

138. Këto lajme mediatike u konsideruan nga trupi gjykues si denoncime publike, të cilat në kuptim të ligjit nr. 84/2016 nuk kanë një afat të kufizuar për paraqitjen e tyre. Nga përmbajtja e denoncimit, u pa i nevojshëm verifikimi nëse ka indiciet e duhura për t'iu nënshtruar hetimit.

139. Këto verifikime u kryen nga trupi gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar.

140. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit mbështetur në nenin B, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 49 pika 10, të ligjit nr. 84/2016, paraqiti një gjetje në formën e një dokumenti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar, ku rezultonte se deri në atë moment nuk kishte indicie, të cilat të ngrinin dyshime lidhur me subjektin e rivlerësimit.

141. Komisioni komunikoi në rrugë elektronike me dy prokurorët e çështjes, të cilët informuan atë se nuk kishin asnjë të dhënë që të përfshinte subjektin e rivlerësimit me çështjen e përfolur mediatikisht. Për këtë fakt ata kanë paraqitur edhe dokumentacion provues ligjor.

142. Verifikimet çuan Komisionin në përfundimin se deri në atë moment nuk ekzistonte asnjë indicie serioze që mund të çonte në rihapjen e hetimeve.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, mbështetur në nenin 59 pika 1, të ligjit nr.84/2016, bazuar në provat që disponoi, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, konstaton se subjekti i rivlerësimit:

- a) ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, dhe;
- c) ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 4 pika 2, nenin 58, pika 1, germa "a", si dhe në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prela, me funksion prokurore/ drejtuese në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 5.2.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES
Roland Ilia

ANËTAR
Olsi Komici

RELATORE
Valbona Sanxhaktari

Sekretare gjyqësore
Fiorela Mandro